# DËSHMI ARKIVI

**A-474983**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Nuk ka kthim pas!”/ 121 ditë revoltë, protesta hyn në muajin e 5-të, qytetarët: Rama jep dorëheqjen! Drejtësia të veprojë |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/nuk-ka-kthim-pas-121-dite-revolte-protesta-hyn-ne-muajin-e-5-te-qytetaret-rama-jep-doreheqjen-drejtesia-te-veproje/1030261/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 05:33:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 05:30:14 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `15734df18e97f30ec1fe05f9c51091e7b2e773e221d1be970e06fd5e60d38ac7` |
| TEKSTI | `5126ec55d3e18f290a1ac768016d9c5ec475641630da65f18de2961717b7bd08` |
| PAMJA | `90cd589884824fe513798d19fa1b56e67005a8247bf86b5db431afb6d3e76955` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a39d04833d4849b682635d63ddcaf395c5f1995d3bfb84bc74dd19b734d9b2aa` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `2fad39eb4a5630a03d13ec48550b069ca76ccbe736c7b94b7af60112a505f929` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a39d04833d4849b682635d63ddcaf395c5f1995d3bfb84bc74dd19b734d9b2aa`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Nuk ka kthim pas!”/ 121 ditë revoltë, protesta hyn në muajin e 5-të, qytetarët: Rama jep dorëheqjen! Drejtësia të veprojë



Protesta qytetare kundër qeverisë vijon sot me ditën e 121-të, ndërsa qytetarët dhe aktivistët pritet të mblidhen sërish në Tiranë, një ditë pas protestës së 120-të, e cila u shoqërua me fjalime, pankarta, flakadanë dhe marshim në rrugët e kryeqytetit.

Protesta e së dielës nisi me grumbullimin e qytetarëve dhe vijoi me fjalime pranë Kryeministrisë. Pas përfundimit të fjalimeve, protestuesit marshuan në rrugët e Tiranës, duke shoqëruar lëvizjen me flamuj, pankarta dhe flakadanë. Gjatë marshimit u dëgjuan thirrje si “Edi Rama, jep dorëheqjen”, “Ju erdhi fundi”, “Arrestoni Ramën”, “Revolucion”, “Studentë bashkohuni, kombi na thërret” dhe “Poshtë narkoshteti”.

Një prej mesazheve të përsëritura gjatë protestës ishte edhe “Shqipëria nuk shitet”, ndërsa protestuesit kërkuan pjesëmarrje më të madhe të të rinjve, me thirrjen “Pa rini nuk ka Shqipëri”. Pankartat dhe sloganet e ditës së 120-të pasqyruan kërkesat e protestuesve për ndryshime politike dhe institucionale.

Në qendër të kërkesave vijon të jetë dorëheqja e kryeministrit Edi Rama. Protestuesit kërkojnë gjithashtu krijimin e një qeverie tranzitore dhe ndryshimin ose anulimin e disa ligjeve që, sipas tyre, janë në kundërshtim me interesat e qytetarëve. Organizatorët dhe pjesëmarrësit kanë deklaruar se protesta do të vijojë edhe pas përmbushjes së 120 ditëve.

Një nga mesazhet e forta të protestës së djeshme erdhi nga aktivisti Dritan Goxhaj, i cili deklaroi se nuk ka kthim pas dhe se protesta duhet të vijojë pa përshkallëzim të dhunshëm. Sipas tij, përdorimi i dhunës do t’i shërbente pushtetit, ndërsa protestuesit duhet të vazhdojnë qëndresën paqësore. Goxhaj tha se synimi i tyre është një Shqipëri e çliruar nga korrupsioni dhe nepotizmi, ndërsa theksoi se lodhja është pjesë e “çmimit të lirisë”.

Goxhaj ngriti gjithashtu kritika ndaj mënyrës së funksionimit të institucioneve dhe sistemit shëndetësor, duke kërkuar që drejtuesit e policisë të mos lidhen me krimin dhe që qytetarët të kenë shërbime shëndetësore funksionale. “Jemi këtu jo sepse nuk jemi lodhur dhe nuk kemi zgjidhje tjetër, por besojmë në këtë Shqipëri”, deklaroi ai.

të fundit/


“Nuk ka kthim pas!”/ 121 ditë revoltë, protesta hyn në muaji…


Begaj mbledh sot Këshillin e Sigurisë Kombëtare pas largi…


Parashikimi i motit 28 Shtator 2026, kthjellime dhe vranësira kalimtare


Horoskopi 28 Shtator/ Dashuri dhe debate, zbuloni surprizat e…


Tragjedia në Athinë/ Çfarë e shkaktoi shpërthimin që i mori…


Napoli zgjat kontratën e Amir Rrahmanit, mbrojtësi do të fitojë…


Greqia shkakton befasinë e madhe ndaj Gjermanisë, 22 vite p…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Gjatë ditës së 120-të, protestuesit përdorën edhe një tjetër mesazh simbolik, duke ironizuar shprehjen "Noc Rrok" të kryeministrit Rama me pankartën "Knock-knock", në një referencë ndaj kërkesave të tyre për drejtësi dhe përgjegjësi institucionale. Në të njëjtën protestë u përsëritën edhe thirrjet për arrestimin e Ramës.

Protesta e djeshme u zhvillua në një moment të tensionuar të debatit politik, pas zhvillimeve rreth ish-drejtueses së SHISH, Vlora Hyseni, dhe publikimit të materialeve nga hetimi. Çështja ishte një nga temat e përmendura edhe në protestë, ndërsa protestuesit kërkuan përgjegjësi dhe hetim nga institucionet e drejtësisë.

Në ditën e 120-të u shfaqën gjithashtu mesazhe kundër qeverisë lidhur me AKSHI-n dhe çështje të tjera që kanë dominuar protestat e ditëve të fundit. Një prej pankartave u drejtohej SPAK-ut me kërkesën për veprim, ndërsa gjatë marshimit u përsëritën thirrjet për vënien para drejtësisë të zyrtarëve.

Shtuar më 28.09.2026 07:30

Tags: 121 ditë revoltë , protesta


Parashikimi i motit 28 Shtator 2026, kthjellime dhe vranësira kalimtare


Tragjedia në Athinë/ Çfarë e shkaktoi shpërthimin që i mori jetën të rinjve…


Aleksandër Vuçiç jep dorëheqjen si president i Serbisë, ua lë "amanet"…



Këlliçi akuzon Ramën pas kthimit nga SHBA: "Kryehajdut i shqiptarëve…


E rëndë në Fier/ Banesa u përfshi nga flakët, çatia i ra në kokë, humb jetën i…


Arben Kola: Ramën e braktisën në SHBA, Vlora Hyseni spiunazh kundër…



Aksident tragjik në Cërrik/ U përplas me shtyllën, humb jetën 21-vjeçari


Slatina e Mokrës në Pogradec, po zbrazet nga banorët: Na mungon zëri …

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko…  Kërko

**Kryesore**
- Erion Veliaj
- Free Esim
- Zgjedhjet 2025
- Belinda Balluku
- SPAK
- Kombëtarja

**Kategori**
- Lifestyle
- Showbiz
- Tech
- Shëndetësi
- Argetim
- Enciklopedi

**Linqet**
- Live tv shqiptare
- Moti në Shqipëri
- Travel
- Horoskopi
- Livescore
- News from Albania

**Tags**
- Edi Rama
- Albania News
- Ilir Meta
- Piranjat
- gazeta, tv, portale
- Sali Berisha

**Moti**
- Moti në Tiranë
- Moti në Prishtinë
- Moti në Shkup
- Moti në Durrës
- Moti në Prizren
- Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.